

REPUBLIKA E SHQIPERISE



Bashkia Kruje

Keshilli Bashkiak

VENDIM

NR 31 DATE 31 / 05 / 2016

Mbi miratimin e kritereve dhe dokumentacionit shoqerues per dhenien e ndihmes ekonomike te menjehershme per familjet ne nevoje .

Keshilli I Bashkise Kruje ne mbledhjen e dates 31 / 05 / 2016

Duke u bazuar ne ligjin nr 139/2015 " Per veteqeverisjen vendore", ligjit nr 9936 date 26.06.2008 " Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise ", te ligjit nr 147/2015 date 24.12.2015 "Per buxhetin e vitit 2016" Si dhe te vendimit te Keshillit Bashkiak nr , 7 date 17.02 .2016 „ Per miratimin e buxhetit te bashkise „ dhe ne mbeshtetje te nenit 21 te ligjit nr 9355 date 10.03.2005 ndryshuar me ligjin nr 10399 date 17.03.2011 per ndihmen dhe sherbimet shoqerore dhe te pikes 9 te nenit 29 te po ketij ligji .

VENDOSI:

1.Te trajtohen me ndihme te menjehershme familjet te cilat kanë nje pjestar te familjes me semundje te rende , kur kerkohet nje nderhyrje kirurgjikale apo nje trajtim mjeksor I gjate .

Masa e ndihmes te caktohet nga Keshilli Bashkiak ne vartesi te fondit dhe te nevojave te familjes.

2.Te ndihmohen me ndihme te menjehershme familjet e varfera kur ne menyre te papritur ndahet nga jeta nje pjesetar I familjes si aksident, vetevrasje etj.

Masa e Ndhimes përcaktohet me Vendim te Keshillit Bashkiak ne baze te mundesive financiere qe ka Bashkia.

3. Te trajtohen me ndihma te menjehershme familjet te cilat ne menyre te menjehershme humbasin te gjitha mjetet e jeteses si permbytje, rreshqitje dheu, zjarret etj pavaresisht nga te ardhurat e tjera qe perfitojne nga shteti.

Masa e ndihmes percaktohet nga keshilli Bashkiak ne baze te gjendjes financiare qe ka Bashkia.

4. Te trajtohen me ndihma te menjehershme familjet ekstremisht te varfere atehere

kur shikohet se jeta e tyre eshte ne rrezik.

Masa e ndihmes te caktohet nga Keshilli Bashkiak ne baze te nevojave financiare qe ka Bashkia.

5. Te trajtohen me ndihme te menjehershme familjet e varfere te cilet nuk mund te perballojne arsimimin e femijeve te tyre

6. Familjet te cilet kane 2 femije qe vazhdojne studimet e larta, te

Masa e ndihmes te percaktohet nga keshilli bashkiak ne baze te gjendjes financiare qe ka Bashkia dhe ne baze te nevojave qe kane familjet.

7. Familjet e ngujuara kur pjesetaret e familjes nuk jane ne gjendje te punojne per shkak te kushteve sociale te tyre.

8. Familjet qe kane nje prind invalid, paraplegjik, tetraplegjik

Dokumentacioni qe duhet te paraqesin.

1. Certifikat familjare

2. Certifikat vdekje

3. Karte identiteti

4. Vertetim Shkollë

5. Ne rast te semundjeve te renda duhen te paraqesin raportin mjekesor ku te percaktohet diagnoza e semundjes.

6. Vertetim paunesia nga zyra e punes. Ne mbeshtetje te ligjit 139 dt 2015 "Per Veteqeverisjen Vendore" kerkojme miratimin e kriterëve per dhenien e ndihmes se menjehershme nga fondet e Bashkise.

Sekretari Keshillit Bashkiak

MALIQ REÇI

Kryetari Keshillit Bashkiak

HYSNI CACA